FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.133 11 tetor 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.629, datë 12.9.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe, bodrumit, të mjediseve të tjera dhe të territorit të ish-spitalit civil të Shkodrës nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Shkodrës ……	3675
Vendim i KM nr.630, datë 29.9.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.135, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve"	3680
Vendim i KM nr.631, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit……..	3680
Vendim i KM nr.632, datë 29.9.2007	Për përcaktimin e rasteve të përjashtimit të pagesave cash për blerje mallrash dhe shërbimesh……..	3681
Vendim i KM nr.634, datë 29.9.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Tiranë …….....	3682
Vendim i KM nr.635, datë 29.9.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së ndërmarrjes gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave……	3685
Vendim i KM nr.636, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Zagorie të qarkut të Gjirokastrës …….	3690

Vendim i KM nr.637, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Roskovec të qarkut të Fierit……	3690
Vendim i KM nr.638, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Sinjë të qarkut të Beratit ……	3691
Vendim i KM nr.639, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Vlorë të qarkut të Vlorës ……	3691

VENDIM
Nr.629, datë 12.9.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË KATIT PËRDHE, BODRUMIT, TË MJEDISEVE TË TJERA DHE TË TERRITORIT TË ISH-SPITALIT CIVIL TË SHKODRËS, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe, bodrumit, të mjediseve të tjera dhe të territorit të ish-spitalit civil të Shkodrës, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Shkodrës, të përcaktuar në formularin nr.3, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Universitetit të Shkodrës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në këtë vendim.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3 - FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror : **Ministria e Shendetesise**

Identifikoi : **Donard Stermasi - Shef i Sektorit Investimeve**

Bashkia : Shkoder

Supervizoi : _____

Fusha e perdorimit te prones : **Shendetesi**

Aprovoi : **Durim Kraja - Drejtor i Drejtorise Ekonomike**

	A		B				C			
Nr	Zona Kadast. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vendndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa / Vendndodja e komponenteve perberes te Prones	Permasat e Prones ne (m²)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Spitali Rajonal Shkoder	Urgjenca + Sallat operac.	Brenda territorit	3196	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Rep. Kirurgjise	Brenda territorit	256	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Materniteti	Brenda territorit	1357	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Muri rrethues	Brenda territorit	677	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Vendroja	Brenda territorit	23	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Sanatoriumi Shkoder	Godina		450	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" "	Muri rrethues	Brenda territorit	293	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" "	Trualli	Brenda territorit	4160	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Spitali Infektiv Shkoder	Godina		716	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Muri rrethues + Vendroja	Brenda territorit	318	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Trualli	Brenda territorit	5510	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Spitali Pediatrik Shkoder	Godina		1180	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Dhomat e nenave	Brenda territorit	292	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Poliklinika Qender Shkoder	Godina	Qender qytetit	590	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" "	Trualli	Qender qytetit	1457	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Poliklin. L.Dergut Shkoder	Godina	Lagja Dergut	.	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Spitali Psikiatrik Shkoder	Godina		1100	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Garazh + Rep.marangoz	Brenda territorit	70	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			Spitali Civil Shkoder	Godina e pavioneve	Brenda territorit	1021	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Rep. Pranimit	Brenda territorit	110	Sherb. mjekesor	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Lavanderia+marangozi	Brenda territorit	1085	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Garazhet	Brenda territorit	152	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	
			" " "	Rrethimi + Trualli	Brenda territorit	8297	Sherb. ndihmes	Drejt. Spitaleve	Drejt. Spitaleve	

PLANIMETRIA E SPITALIT CIVIL SH 1-500

PLANIMETRIA E BODRUMIT SH. 1 : 200



STUDIO PROJEKTIMI NDOI LEZHE

OBJEKTI	RIKONSTRUKSION I SPITALIT CIVIL SHKODER			
VIZATIMI	PLANIMETRIA E KATIT TE PARE SH. 1:200			
AUTOR	ING.ARDIAN NDOI		PERPUNOI	ING. SOKOL TOMA
AUTOR	ING.SOKOL TOMA		INVESTITORI	

VENDIM

PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE SH. 1 : 200



STUDIO PROJEKTIMI NDOI I.P.ZHE

OBJEKTI	RIKONSTRUKSION I SPITALIT CIVIL SHKODER			
VIZATIMI	PLANIMETRIA E KATIT TE PARE SH. 1:200			SHKODER 2008
AUTOR	ING.ARDIAN NDOI		PERPUNDI	ING. SOKOL TOMA
AUTOR	ING.SOKOL TOMA		INVESTITORI	

Nr.630, datë 29.9.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.135, DATË 14.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË QENDRORE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE DHE PËR SHKRIRJEN E QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE TË PROVIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8 e vendimit nr.135, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "titullar i institucionit", të Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve caktohen në mbështetje të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës.".

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.631, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM , TË KOMUNËS MOLLAS TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.18, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Mollas të qarkut të Elbasanit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Mollas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve mësimore;	Në pronësi
6	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit;	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik;	Në pronësi
9-13	Infrastrukturë (sheshe);	Në pronësi
14-39	Shërbimi funeral;	Në pronësi
40-46	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik;	Në pronësi
154-248;330-418	Infrastrukturë (rrugë vendore);	Në pronësi
304	Prona që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm;	Në pronësi
110;111;116;117;118;119;121;125-127;131-134;139-141;145-147;151-153;250;254;257;258;273;	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive);	Në pronësi
106-109;112-115;120;122-124;128-130;135-138;142-144;148-150	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive);	Në përdorim

VENDIM
Nr.632, datë 29.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE TË PËRJASHTIMIT TË PAGESAVE CASH PËR BLERJE MALLRASH DHE SHËRBIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kufiri i lejuar i blerjeve me para në dorë, (cash), deri në 10 për qind të totalit të blerjeve, për vitin 2007, llogaritet nga data 6.8.2007, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9767, datë 9.7.2007, deri më 31.12.2007.

Për vitet pasardhëse, ky kufi shtrihet gjatë të gjithë vitit fiskal, i cili përputhet me vitin kalendarik.

2. Përjashtohen nga rregulli i përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, tatimpaguesit, që kryejnë blerje, me para në dorë, nga individë të paregjistruar në organet tatimore dhe që ushtrojnë veprimtari ekonomike, në fushën:

a) e grumbullimit dhe të përgatitjes për riciklim të mbeturinave dhe mbetjeve, metalike e jometalike (letër, gomë, sende plastike, tekstile, qelq etj.);

b) e grumbullimit dhe të përpunimit të bimëve mjekësore;

c) e grumbullimit dhe të përpunimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkut.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.634, datë 29.9.2007

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË TUFINËS, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Tiranë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 563 m^2 tokë/arë, me çmimin 4 000 (katër mijë) lekë/m^2, vlerësuar në shumën e përgjithshme 18 252 000 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.
4. Ky fond të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale është 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, e cila do të përballohet po nga Bashkia e Tiranës.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 25.10.2007.
7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.
8. Regjistrimi i ri për Bashkinë e Tiranës i pasurisë 4 563 m^2 tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE DHE VLERA NË LEKË SIPAS ÇERTIFIKATËS SË PRONËSISË

VARREZAT "TUFINË"

Sipërfaqja që do të shpronësohet është truall me nr.pasurie 26/19

Hysni Abdyl Qefalia

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Sip. M^2	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Hysni Qefalia	3426	4563	4000	18,252,000	Çertifikatë

Vlera mesatare e shitjeve është llogaritur duke u bazuar në shkresën **Nr.8313/1 Prot. Dt.12.01.2007** ardhur nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Tiranë, e cila do të jetë bashkëlidhur këtyre llogaritjeve.

ZYRA E REGJISTRIMIT
I PASURIVE TE PALUAJSHME

REGJISTRUESI
MAJLINDA BOZGO

Vula

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3426 NR. I PASURISE 26/19 Vol. 1 Fq. 121

INDEKSI I HARTES K-34-88(236-13) SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TUFDIE

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V. 441

L. 26/29

J. 26/20

P. 615

C. PRONARI/ET

HYSNI QEFALIA

D. Data: 09/2006, Ora: _____



VENDIM
Nr.635, datë 29.9.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NDËRTESËS SË NDËRMARRJES GJEOLOGJIKE, KORÇË, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TE MINISTRIA E FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pjesës dykatëshe të ndërtesës së Ndërmarrjes Gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave, për t'u përdorur nga drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore, Korçë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e procedurave për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Legjenda:

A. OBJEKTI NDËRTIMOR

Nr. 1 ; Nr 2, është bërë transferim kapitali ne Sushtetin Lokal Korçë

B. OBJEKTI NDËRTIMOR.

Nr. 3; 4; 5; 6; 7; 8; 9; 10 është privatizuar.

C. OBJEKTI TRUALL I LIRË me nr. 11 është privatizuar.

D. OBJEKTI Ndërtimor Nr. 12.
Ofisine dhe magazinë.
Sipërfaqja nen objekt. 430.5 m²
Sipërfaqja funksionale
Sipërfaqja totale 430.5 m²

E. OBJEKTI
Sipërfaqja




20.50
OFICINE - MAGAZINE
41.00
ZYRA E MAGAZINA
10.70
3000
10.50
40.50
RRUGA : KORÇE - BILISHT

Lista e shoqerive / ndermarrjeve prone publike, per kalimin e se drejtes se perfaqesuesit te pronarit

Nr.	Shoqeria / Ndermarrja	. Statusi	Rrethi	Qyteti	Vartesia administrati
1	Mekanika Industrise Ushqimore Sh.A.	Shoqeri Anonime	Elbasan	Elbasan	Lokale
2	N. G. P. Drithi Sh.A.	Shoqeri Anonime	Korçe	Korçe	MBU
3	Sheqeri Maliq Sh.A.	Shoqeri Anonime	Korçe	Maliq	MBU
4	Alimpeks Sh.A.	Shoqeri Anonime	Tirane	Tirane	MBU
5	Fondermek Sh.A.	Shoqeri Anonime	Tirane	Tirane	MEPP
6	IB. ALB ELECTRONICS Co.	Shoqeri e pe. bashket ne likuidim	Durres	Durres	MEPP
7	Dega N.F.I.L.	Ndermarrje Shteterore	Berat	Berat	MEPP
8	Tezgjahu Nr. 1	Ndermarrje Shteterore	Berat	Berat	MEPP
9	N. Prodhim Buke	Ndermarrje Shteterore	Bulqize	Bulqize	MBU
10	N. G. P. Drithi	Ndermarrje Shteterore	Diber	Peshkopi	MBU
11	N. G. P. Qumshti	Ndermarrje Shteterore	Diber	Peshkopi	MBU
12	N. Blojes nr. 1	Ndermarrje Shteterore	Diber	Peshkopi	MBU
13	N. Blojes nr. 2	Ndermarrje Shteterore	Diber	Peshkopi	MBU
14	N. Riveshje Goma	Ndermarrje Shteterore	Durres	Durres	MEPP
15	Uzina M. Bujqesore	Ndermarrje Shteterore	Durres	Durres	MEPP
16	N. Tregeti me Shumice	Ndermarrje Shteterore	Durres	Durres	MBET
17	Makinaimpeks	Ndermarrje Shteterore	Durres	Durres	MBET
18	N. Frigoriferit	Ndermarrje Shteterore	Elbasan	Elbasan	Lokale
19	Dega N. F. I. L.	Ndermarrje Shteterore	Elbasan	Elbasan	MEPP
20	Uzina Seleksionimit Koksit	Ndermarrje Shteterore	Elbasan	Elbasan	MEPP
21	Uzina Seleksionimit Metaleve	Ndermarrje Shteterore	Elbasan	Elbasan	MEPP
22	N. Prodhimit Bukes	Ndermarrje Shteterore	Fier	Patos	Lokale
23	Dega N. T. P. N.	Ndermarrje Shteterore	Fier	-	MBET
24	Uzina Pilave	Ndermarrje Shteterore	Gramsh	Gramsh	MM
25	N. Agroregtare	Ndermarrje Shteterore	Has	Has	MBU
26	N. G. P. Drithi	Ndermarrje Shteterore	Has	Has	MBU
27	Fabrika Qelqit	Ndermarrje Shteterore	Kavaje	Kavaje	MEPP
28	Depo Frigoriferike (N. Ushqimore)	Ndermarrje Shteterore	Kolonje	Erseke	MBU
29	Dega Sherbimit Gjeologjik	Ndermarrje Shteterore	Korçe	Korçe	MEPP
30	N Trikotazhit	Ndermarrje Shteterore	Korçe	Korçe	MEPP
31	Uzina Instrumentave	Ndermarrje Shteterore	Korçe	Korçe	MEPP
32	Uzina Mekanikes Bujqesore	Ndermarrje Shteterore	Korçe	Korçe	MEPP
33	N. T. P. N.	Ndermarrje Shteterore	Kukes	Kukes	MBET
34	N. T. Sh.	Ndermarrje Shteterore	Kukes	Kukes	Lokale
35	N. G. P.	Ndermarrje Shteterore	Kurbin	Mamurras	Lokale
36	A. Sh. L. D.	Ndermarrje Shteterore	Kurbin	Laç	MBU
37	Fabrika e Letres Lingosulfonat	Ndermarrje Shteterore	Kurbin	Laç	Lokale
38	N. G. P. Drithi	Ndermarrje Shteterore	Lezhe	Lezhe	Lokale
39	Dega Farnave	Ndermarrje Shteterore	Lezhe	Lezhe	MBU
40	N. R. Sh. Komunale	Ndermarrje Shteterore	Lezhe	Lezhe	Lokale
41	S. M. T.	Ndermarrje Shteterore	Librazhd	Librazhd	Lokale
42	Dega Farnave (Këlliçi Bahaxhi)	Ndermarrje Shteterore	Lushnje	Lushnje	MBU
43	N. G. P. Drithi	Ndermarrje Shteterore	Malesi e Madhe	Koplik	MBU
44	N. G. P. Drithi	Ndermarrje Shteterore	Mat	Mat	MBU

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror

Bashkia: **KORÇË**

Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim Ekonomik

Identifikoi: Ervin KAJNO, Pergj.Sekt.Pronave Publike
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Zhani PEPO, Specialiste e Urbanistikes
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Gjergji DURO, Kryetari i Bashkise
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A		B				C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr.& Indeksi I Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
860	8562 Ko-H-11	6\25	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar Dega Rajonale Korce Rr.Korce -Bilisht	Magazina	Rruga Korçë - Bilisht	210	Zhvillim Ekonomik	Ministria e Ekonomise	Drejtoria e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar Dega Korçe	
				Hangar	Rruga Korçë - Bilisht	188	Zhvillim Ekonomik	Ministria e Ekonomise	Drejtoria e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar Dega Korçe	
				Ndertese	Rruga Korçë - Bilisht	210	Zhvillim Ekonomik	Ministria e Ekonomise	Drejtoria e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar Dega Korçe	Ndertese 4Kat.
				Laborator	Rruga Korçë - Bilisht	504	Zhvillim Ekonomik	Ministria e Ekonomise	Drejtoria e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar Dega Korçe	
				Shesh funksional	Rruga Korçë - Bilisht		Shesh funksional	Ministria e Ekonomise	Drejtoria e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar Dega Korçe	(Mbetur ne admin. shteteror)

VENDIM
Nr.636, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN ZAGORIE TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Zagorie të qarkut të Gjirokastrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 511 (pesëqind e njëmbëdhjetë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.637, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË BASHKINË ROSKOVEC TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë Roskovec të qarkut të Fierit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 34 (tridhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.638, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN SINJË TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 869 (tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

VENDIM
Nr.639, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË BASHKINË VLORË TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 81 (tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 825 (tetëqind e njëzet e pesë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA

(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 9.10.2007
Doli nga shtypi më 11.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë